Devoll Hydropower Sh.A.
Raporti i Audituesit të pavarur dhe Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

Përmbajtja

	Page
Raporti i Audituesit të Pavarur	i
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5 - 28

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
Rr. Elbasanit.
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
www.deloitte.al

VAT (NUIS) No: L41709002H

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Aksionarët e Devoll Hydropower SH.A.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Devoll Hydropower Sh.A. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë.Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde, kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke marrë parasysh edhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo i gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të përcaktojë proçedura auditimi të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Devoll Hydropower Sh.A. më 31 dhjetor 2014, si dhe performancën e saj financiare dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Audit Albania sh.p.k

26 mars, 2015
Tiranë, Shqipëri

Nuriona Sokoli Berdica
Partner Angazhimi

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e pozicionit financiar

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek

	Shënime	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Aktive			
Prona, makineri dhe pajisje	7	16,698,405,814	6,800,944,632
Aktive jomateriale	8	16,047,752	17,431,574
Parapagime	9	1,778,966,785	694,075,901
Totali i aktiveve afatgjata		**18,493,420,351**	**7,512,452,107**
Parapagime	9	995,059,059	338,570,319
Tatim fitimi i parapaguar		105,033	105,033
Të tjera të arkëtueshme	10	312,673,925	575,308,161
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	11	3,635,125,804	2,375,093,660
Totali i aktiveve afatshkurtra		**4,942,963,821**	**3,289,077,173**
Totali i aktiveve		**23,436,384,172**	**10,801,529,280**
Kapitali			
Kapitali aksionar i paguar dhe i nënshkruar	12	22,319,000,000	11,100,000,000
Prim i kapitalit aksionar	13	7,090,000	6,190,000
Humbja e akumuluar		(1,556,304,187)	(1,214,673,718)
Totali i kapitalit		**20,769,785,813**	**9,891,516,282**
Detyrimet			
Shpenzime të përllogaritura	14	1,660,669,014	652,460,628
Llogari të pagueshme	15	991,160,531	241,816,565
Të tjera të pagueshme	16	14,768,814	15,735,805
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**2,666,598,359**	**910,012,998**
Totali i detyrimeve		**2,666,598,359**	**910,012,998**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**23,436,384,172**	**10,801,529,280**

Shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më 26 mars 2015 dhe janë nënshkruar për Devoll Hydropower Sh.A. nga:

Ola By
Drejtori Ekzekutiv

Devoll Hydropower
K 82418002 C

Përgatitur nga:
KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Të ardhura		-	-
Shërbime	17	(191,272,024)	(140,174,668)
Shpenzime personeli	18	(72,103,255)	(33,298,744)
Amortizimi i prona, makineri dhe pajisje	7	(8,105,953)	(6,595,917)
Amortizimi i aktiveve jomateriale	8	(4,478,655)	(5,085,720)
Shpenzime të tjera	19	(56,968,359)	(59,220,725)
Humbja nga aktiviteti i zakonshem		**(332,928,246)**	**(244,375,774)**
Të ardhurat financiare neto			
Fitimet/(humbjet) nga kurset e këmbimit, neto	20	(27,108,975)	2,864,852
Të ardhura financiare, neto	21	18,406,752	7,537,778
		(8,702,223)	**10,402,630**
Humbja para tatimit		**(341,630,469)**	**(233,973,144)**
Tatimi mbi fitimin	22	-	-
Humbja e vitit		**(341,630,469)**	**(233,973,144)**
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin		**(341,630,469)**	**(233,973,144)**

Shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek

	Kapitali aksionar i paguar dhe i nënshkruar	Prim i kapitalit aksionar	Humbja e akumuluar	Totali
Gjendja më 1 janar 2013	**6,899,590,000**		**(980,700,574)**	**5,918,889,426**
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin				
Humbja e vitit	-	-	(233,973,144)	(233,973,144)
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	**(233,973,144)**	**(233,973,144)**
Transaksione me pronarët të regjistruara direkt në kapital				
Transferime midis zërave të kapitalit	(6,190,000)	6,190,000	-	-
Kontribute nga pronarët	4,206,600,000	-	-	4,206,600,000
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	**4,200,410,000**	**6,190,000**		**4,206,600,000**
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**11,100,000,000**	**6,190,000**	**(1,214,673,718)**	**9,891,516,282**
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin				
Humbja e vitit	-	-	(341,630,469)	(341,630,469)
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	**(341,630,469)**	**(341,630,469)**
Transaksione me pronarët të regjistruara direkt në kapital				
Transferime midis zërave të kapitalit	-	-	-	-
Kontribute nga pronarët	11,219,000,000	900,000	-	11,219,900,000
Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve	**11,219,000,000**	**900,000**	-	**11,219,900,000**
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**22,319,000,000**	**7,090,000**	**1,556,304,187**	**20,769,785,813**

Shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e flukseve monetare
Të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Aktivitetet operative			
Humbja e vitit		(341,630,469)	(233,973,144)
Rregullime për:			
Amortizimi për prona, makineri dhe pajisje	7	8,105,953	6,595,917
Amortizimi për aktive jo materiale	8	4,478,655	5,085,720
Humbje nga nxjerrjet jashtë përdorimit	19	-	2,929,317
Fitime / (humbje) të parealizuara nga monedhat e huaj e mbajtur në arkë dhe bankë		1,525,673	(10,275,895)
Të ardhura nga interesi	21	(18,425,758)	(7,537,981)
Shpenzime interesi	21	19,006	203
Ndryshime në kapitalin punues:			
Ndryshimi ne llogaritë e tjera të arkëtueshme	10	749,343,966	205,490,980
Ndryshimi rritja në llogaritë e pagueshme	15	123,298	3,574,488
Ndryshimi në të tjera të pagueshme	14,16	*666,174,560*	*(95,043,233)*
Flukset monetare përdorur në aktivitetet		262,634,236	(66,932,838)
Interesa të arkëtuara		18,425,758	7,537,981
Interesa të paguara		(19,006)	(203)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet e shfrytëzimit		**684,581,312**	**(87,505,455)**
Aktivitetet investuese			
Pagesa për blerjen e pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe aktiveve jomateriale	7,8	(8,901,543,871)	(1,457,782,229)
Rritje në parapagime		(1,741,379,624)	(996,067,193)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet investuese		**(10,642,923,495)**	**(2,453,849,422)**
Aktivitetet financuese			
Derdhje kapitali nga aksionarët	12	11,219,900,000	4,206,600,000
Flukset monetare përdorur në aktivitetet financuese		**11,219,900,000**	**4,206,600,000**
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to		1,261,557,817	1,665,245,123
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit		**2,375,093,660**	**699,572,642**
Efekti i luhatjeve të kurseve të këmbimit në paratë e mbajtura në arkë dhe bankë		(1,525,673)	10,275,895
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	11	**3,635,125,804**	**2,375,093,660**

Shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Të përgjithshme

Informacion i përgjithshëm mbi Shoqërinë

Devoll Hydropower Sh.A. ("Shoqëria") është themeluar dhe e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar. Devoll Hydropower Sh.A. është regjistruar në datën 18 dhjetor 2008 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me NIPT K82418002C dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Bazuar në Ligjin nr.10083 të datës 23.02.2009, shoqëritë EVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower SH.A. u shpallën fitues të marrëveshjes koncesionare BOOT me objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e Hidrocentralit të Devollit, me vendndodhje në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll, midis komunës Maliq dhe Banjë

EVN AG dhe Statkraft AS krijuan në Shqipëri një shoqëri aksionare me kapital te përbashkët me emrin Devoll Hydropower SH.A. e cila u përfshi në Marrëveshjen Koncesionare si Shoqëri koncesionare. Më 27 janar 2013 EVN AD ka nënshkruar një marrëveshje me EVN Beteiligung 40 GmbH, një filial i EVN AG në Austri e cila specifikon se EVN AG i transferon 50% të aksioneve të zotëruara në Shoqëri EVN Beteiligung 40 GmbH me anë të një kontributi në natyrë. Gjithashtu, më 28 janar 2013 Statkraft AS hyri në një marrëveshje për blerje aksionesh në të cilën specifikohej së Statkraft AS do të shiste 50% të aksioneve të zotëruara prej saj në Shoqëri, shoqërise Statkraft Market B.V, një filial i Statkraft AS në Hollandë.

Më 14 mars 2013 EVN AG, shoqëria mëmë e EVN Beteiligung 40 GmbH, dhe Statkraft A.S., Shoqëria mëmë e Statkraft Market B.V, arritën në një marrëveshje në lidhje me shitjen e 50% të aksioneve që EVN zotëronte në Devoll Hydropower Sh.A shoqërisë Statkraft. Shitja e aksioneve të EVN-së në Devoll Hydropower Sh.A. te Statkraft ka qenë subjekt i miratimit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, dhe një marrëveshje mes EVN AG, Statkraft AS, Devoll Hydropower Sh.A. dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes të Shqipërisë –METE (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë - MEI) për ndryshimin e Marrëveshjes së Koncensionit, si edhe miratimi e këtij ndryshimi në Marrëveshjen Koncensionare nga Parlamenti i Shqipërisë. Ky miratim u dha më 28 mars 2013.

Më 13 shkurt 2014, Statkraft Markets GmbH, shoqëria mëmë e Statkraft Markets B.V, aksionar i vetëm i Devoll Hydropower, ia shiti kuotat e tij që mbante në Statkraft Market B.V shoqërisë Statkraft Asset Holding A.S. Më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 Statkraft Market B.V është aksionari i vetëm i Devoll Hydropower Sh.A

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Zyra Nr.1204, Tiranë.

Drejtuesit e Shoqërisë

Bordi Drejtues:
Mr. Olav Holland
Mrs. Wenche Lund Øyno
Mrs. Tima Iyer

Drjetori ekzekutiv është Z. Ola By.

Marrëveshja Koncesionare – terma të rëndësishëm

Sipas nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 9663 "Për koncesionet" i datës 18 dhjetor 2006, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463 "Mbi aprovimin e autoritetit kontraktues për dhënien e koncensionit për hidrocentralet në kaskadën e lumit Devoll dhe aprovimin e bonusit në procedurën për përzgjedhjen e ofertës së Shoqërisë" i datës 18.07.2007, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10083 "Mbi aprovimin e Marrëveshjes Koncesionare ndërmjet METE (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë – MEI) dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER SHA, si Shoqëria koncesionare për planifikimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë" data 23.02.2009 ("Marrëveshja Koncesionare") e ndryshuar me Ligj Nr. 10037 datë 21.10.2010 "Për një shtesë në Ligjin 10083 datë 23.02.2009", me Ligj Nr. 105/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 10083 datë 23.02.2009" dhe me Ligj Nr. 7/2015 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083, datë 23.2.2009".

1. Të përgjithshme (vazhdim)

Marrëveshja Koncesionare – terma të rëndësishëm (vazhdim)

Sipas Marrëveshjes Koncesioniare, Shoqëria do të ndërtojë të paktën tre njësi prodhuese hidroelektrike me një kapacitet total rreth 278 MW dhe me një prodhim mesatar përafërsisht 798 GWh në vit energji të ripërtëritshme dhe të pastër.

Koncesioni për hidrocentralet përfshin planifikimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e të paktën tre hidrocentraleve të vendosura në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll. Në përputhje me koncesionin për hidrocentralin, trualli i ndërtimit, përdorimi i ujit të luginës së lumit Devoll ndërmjet lartësive 95-650 metra mbi nivelin e detit, përfshirë dhe Lumin Devoll dhe degëzimet e tij do ti transferohen Devoll Hydropower SH.A.

Sipas Marrëveshjes Koncesionare, Shoqëria koncesionare është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë (që do të prodhohet nga koncesionari). Marrëveshja Koncesionare është organizuar si një model projekti i tipit BOOT (Ndërtim-Zotërim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë prej 35 vjetësh me të drejtë zgjatjeje automatike pas përmbushjes së disa kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen Koncesionare. Pas kësaj periudhe hidrocentrali do ti transferohet METE-s (aktualisht Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë – MEI) pa asnjë tarifë, bashkë me pajisjet e lidhura, të drejtat dhe kontratat.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë autorizuar për lëshim nga Bordi i Drejtorëve më 26 mars 2015.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazat e kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqiptar (Lek), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(a) Përdorimi i parashikimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nevojën e menaxhimit për të bërë gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare është përfshirë në shënimin 5.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës së raportimit. Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Instrumente financiarë

Fillimisht Shoqëria i njeh llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në mjete monetare në datën e krijimit. Të gjitha instrumentet e tjera janë njohur fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuare të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuare mbi flukse e parasë nga aktivet financiare skadojnë, ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuare të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuar që është krijuar apo mbajtur nga Shoqëria është njohur si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përftojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo derivativë të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme të tjera, paraja dhe ekuivalente të saj, detyrimet tregtare dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat me maturitet me më pak se tre muaj.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e detyrimeve tregtare dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Të tjera instrumente financiare jo derivative janë të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si zë i kapitalit.

(c) Prona, makineri dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Zëri prona, makineri dhe pajisje është matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një prone, makinerie dhe pajisjeje kanë jetë-gjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme) të pronave, makinerive dhe pajisjeve.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri te prona, makineri dhe pajisje janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të pronës, makinerisë dhe pajisjes dhe janë pasqyruar neto në zërin të ardhura të tjera të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Zhvlerësimi (vazhdim)

(ii) Aktivet jo financiare

Vlerat kontabël (neto) të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në pasqyrën e te ardhurave ose shpenzimeve.

(f) Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan kontributi i përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

(g) Provigjionet

Një provigjion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lind një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të parashikohet me siguri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet janë përcaktuar duke aktualizuar flukset e pritshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare

(h) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiratë e zakonshme janë njohur në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Lehtësirat e përfituara për qiratë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare. Fitimet dhe humbjet nga konvertimi janë paraqitur neto.

(j) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton efektet tatimore që do të lindnin nga mënyra se si Shoqëria pret që në fund të periudhës raportuese, të realizojë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa të mos jetë më e mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit të periudhës dhe tatimit të shtyrë, Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e pasigurtë të pozicionit të taksave dhe nëse mund të ngarkohen taksa shtesë ose interesa. Shoqëria beson se përllogaritjet e bëra për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura, bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të legjislacionit tatimor dhe përvojave të mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në parashikime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të disponueshme, mund të ndikojnë në ndryshimin e vendimit të Shoqërisë në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojë në shpenzimet tatimore në periudhën që është bërë një përcaktim i tillë.

(k) Standarde dhe interpretimet e reja ende të pa adoptuara

Një numër standardesh, rishikimesh të standardeve dhe interpretime të standardeve janë efektive për vitet që fillojnë pas datës 1 janar 2014 (të listuara më poshtë), dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- **SNRF 9** ***Instrumentet Financiarë (2014)*** (Efektiv për periudha duke filluar nga ose pas 1 janarit 2018; të zbatohet në mënyrë retrospektive me disa përjashtime. Zbatimi i hershëm është i lejuar. Riparaqitja e periudhave paraardhëse nuk kërkohet dhe lejohet vetëm nëse informacioni mund te gjendet pa përdorur informacionin retrospektiv.)
- **SNRF 15** ***Të ardhurat nga kontratat me klientët*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2017. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNRF 14** ***Llogaritë e shtyra për qëllime rregullatore*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNK 1** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNK 16** ***Prona, makineri dhe pajisje pune*** **dhe SNK 41** ***Agrikultura*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNK 16 dhe SNK 38:** ***Sqarimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016; të zbatohet në mënyrë retrospektive. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNK 27:** ***Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016; të zbatohet në mënyrë retrospektive. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNRF 10 dhe SNK 28** ***Shitja apo kontributi në aktive ndërmjet një investitori dhe njësisë ku ka marrë pjese ne investim ose një sipërmarrje të përbashkët*** (Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016; të zbatohet në mënyrë prospektive. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNRF 11:** ***Kontabiliteti për Blerjet e Interesave në Operacionet e Përbashkëta*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016; të zbatohet në mënyrë prospektive. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **Ndryshime të SNK 19 –** ***Përfitimet e punonjësve*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 korrikut 2014. Zbatimi i hershëm është i lejuar. Ndryshimet aplikohen në mënyrë retrospektive.)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Ka disa ndryshime të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit dhe interpretime të lëshuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar të cilat u bënë efektive për periudhën aktuale. Asnjë nga këto nuk ka efekt te konsiderueshëm në këto pasqyra financiare.

- **Ndryshime të SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 –** ***Entitetet investuese*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2014; adoptimi I hershëm është I lejuar; të zbatohet nw mënyrë retrospektive sipas dispozitave kalimtare)
- **Ndryshime të SNK 32** ***Netimi i aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2014; të zbatohet në mënyrë retrospektive. Zbatimi i hershëm është i lejuar, megjithatë duhet të bëhen shënime shpjeguese shtesë sipas Ndryshime të SNRF 7 Shënimet shpjeguese- Netimi i aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare mund te behet)
- **Ndryshime të SNK 36 –** ***Shënimet shpjeguese për vlerën e rikuperueshme të Aktiveve Jo-financiare*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2014; të zbatohet në mënyrë retrospektive. Zbatimi i hershëm është i lejuar, megjithatë një entitet nuk duhet të zbatojë ndryshimet në periudha(përfshirë periudha krahasuese) në të cilat ai nuk aplikon gjithashtu dhe SNRF 13)
- **Ndryshime të SNK 39 –** ***Novacioni i Derivativëve dhe Vazhdimi i Kontabilitetit Mbrojtës*** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2014; të zbatohet në mënyrë retrospektive. Zbatimi i hershëm është i lejuar, megjithatë një entitet nuk duhet të zbatojë ndryshimet në periudha(përfshirë periudha krahasuese) në të cilat ai nuk aplikon gjithashtu dhe SNRF 13)
- **KIRFN 21 –** ***Taksat*** *(*efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2014; Zbatohet në mënyrë retrospektive; zbatimi më i hershëm është i lejuar)

Adoptimi i këtyre interpretimeve dhe ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime të politikave kontabël të Shoqërisë apo në efekte te rëndësishme në pasqyrat financiare.

4. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika dhe shënime të rëndësishme kontabël të përdorura nga Shoqëria që kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivet ashtu dhe për detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar vetëm për qëllime paraqitje. Kur është e aplikueshme, një informacion i mëtejshëm për supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta, është trajtuar në shënimet që janë specifike për atë aktiv ose detyrim.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet kontabël janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim mbi fitimin të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatimin mbi fitimin aktiv dhe pasiv aktual ose të shtyrë në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme e prona, makineri dhe pajisje

Siç është përshkruar në shënimin 3 (c), Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për prona, makineri dhe pajisje nuk ka ndryshuar.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

TVSH e zbritshme

Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar zhvlerësimin e TVSH-së për t'u rimbursuar në fund të vitit dhe vlerësoi se do të merret plotësisht në vitet e ardhshme.

6. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumenteve financiarë:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë.

(a) Rreziku i kreditimit

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saja të trajnimit dhe drejtimit synon të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni për rolet dhe detyrimet e tyre. Instrumentet kryesorë financiarë të Shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet me to, të tjera të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme.

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rreziqeve të konsiderueshme të kreditit. Konkretisht, më 31 dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka instrumente financiare ku një klient apo palë e trete në një instrument financiar do të dështonte në përmbushjen e detyrimeve të tyre kontraktuale (d.m.th. më 31 dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka as llogari të arkëtueshme e as investime në instrumente financiare), përveç mjeteve monetare në bankë në shumën 3,635,125,804 Lek (2013: 2,374,871,905 Lek).

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare të saj të cilat shlyhen me anë të mjeteve monetare apo të ndonjë aktivi tjetër financiar. Qëllimi i Shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, se ajo gjithmonë do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në vështirësi, pa patur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

Shoqëria synon që të sigurojë mbajtjen e likuiditetit të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj brenda 6 muajve të ardhshëm.

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimeve të tregut, të tilla si normat e interesit, normat e këmbimit dhe çmimet e kapitalit që do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare të zotëruara. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhoje dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm ndërsa kthimi maksimizohet.

Rreziku i interesit

Shoqëria nuk përballet me ndonjë rrezik të konsiderueshëm të normave të interesit të flukseve monetare sepse ajo nuk disponon detyrime financiare të cilat gjenerojnë interesa.

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i tregut (vazhdim)

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit lidhur me ndryshimet e mundshme në normat e kurseve të këmbimit për sa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaj.

Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro detyrim ndaj furnitorëve të saj, gjë që ekspozon Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to që maturohen në të njëjtën periudhë në të cilën detyrimet tregtare duhet të shlyhen.

Analiza e ndjeshmërisë

Në menaxhimin e rrezikut të kursit të këmbimit Shoqëria ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kurseve të këmbimit mund të kenë ndikim në fitim. Një analizë e ndikimit të vlerësuar të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur në Shënimin 24.

(d) Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të ruajë një bazë të fortë kapitali, me qëllim të ruajë besueshmërinë e investitorëve, kreditoreve dhe te tregut dhe të ruajë zhvillimet e ardhshme të biznesit.

Nuk ka pasur ndryshime në menaxhimin e kapitalit nga Shoqëria gjatë vitit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të imponuara nga jashtë për kapitalin

7. Prona, makineri dhe pajisje

Prona, makineri dhe pajisje janë të përbëra si vijon:

	Pajisje informatike	Mobilje dhe pajisje zyre	Mjete transporti	Përmirësime të ambienteve me qira	Të tjera mjete dhe pajisje	Aktive në proces –kosto përmirësimi	Aktive në proces	Totali
Kosto								
Më 1 janar 2013	**54,540,461**	**31,681,835**	**34,918,781**	**9,298,845**	**15,660,931**	**85,688,274**	**4,603,478,586**	**4,835,267,713**
Shtesa	12,687,500	8,179,517	40,691,412	6,829,879	30,807,002	-	1,949,167,698	2,048,363,007
Pakësime	(1,852,078)	-	-	-	(82,000)	-	-	(1,934,078)
Më 31 dhjetor 2013	**65,375,883**	**39,861,352**	**75,610,193**	**16,128,724**	**46,385,933**	**85,688,274**	**6,552,646,284**	**6,881,696,643**
Shtesa	37,547,717	8,045,505	6,937,208	31,417,441	42,226,425	-	9,810,145,534	9,936,319,830
Më 31 dhjetor 2014	**102,923,600**	**47,906,857**	**82,547,401**	**47,546,165**	**88,612,358**	**85,688,274**	**16,362,791,818**	**16,818,016,473**
Amortizim i akumuluar								
Më 1 janar 2013	**22,098,521**	**13,885,066**	**12,531,051**	**1,097,369**	**5,852,992**	-	-	**55,464,999**
Amortizimi i vitit	8,762,703	4,032,240	6,476,257	489,244	6,640,515	-	-	26,400,959
Pakësime	(1,072,533)	-	-	-	(41,414)	-	-	(1,113,947)
Më 31 dhjetor 2013	**29,788,691**	**17,917,306**	**19,007,308**	**1,586,613**	**12,452,093**	-	-	**80,752,011**
Amortizimi i vitit	12,050,911	5,296,178	11,783,057	1,133,733	8,594,769	-	-	38,858,648
Më 31 dhjetor 2014	**41,839,602**	**23,213,484**	**30,790,365**	**2,720,346**	**21,046,862**	-	-	**119,610,659**
Vlera kontabël (neto)								
Më 1 janar 2013	**32,441,940**	**17,796,769**	**22,387,730**	**8,201,476**	**9,807,939**	**85,688,274**	**4,603,478,586**	**4,779,802,714**
Më 31 dhjetor 2013	**35,587,192**	**21,944,046**	**56,602,885**	**14,542,111**	**33,933,840**	**85,688,274**	**6,552,646,284**	**6,800,944,632**
Më 31 dhjetor 2014	**61,083,998**	**24,693,373**	**51,757,036**	**44,825,819**	**67,565,496**	**85,688,274**	**16,362,791,818**	**16,698,405,814**

7. Prona, makineri dhe pajisje (vazhdim)

Nuk ka zëra të prona, makineri dhe pajisje të dhëna si kolateral më 31 dhjetor 2014.

Aktive në proçes – përmirësime dhe ndërtime përfaqësojnë ndërtimin e rrugës Gramsh – Kodovjat. Punimet konsistojnë në zgjerimin e rrugës ekzistuese në një platformë rrugore prej 6 m duke përfshirë 5 m karrexhatë dhe 0.5 m bordurë. Këto punime janë të lidhura ngushtë me zbatimin e projektit koncesionar të Devoll Hydropower dhe janë të nevojshme për realizimin e këtij projekti.

Aktive në proçes përfaqësojnë shërbime konsulence të kryera për zhvillimin e projekteve si dizenjim, planifikim dhe shërbime inxhinierike. Në këtë kategori janë përfshirë shpenzimet e tjera që i atribuohen aktivit të vetë-ndërtuar si amortizimi i pajisjeve teknike, pagat e inxhinierëve dhe punëtorëve të përfshirë në dizenjime dhe shërbime inxhinierike.

Amortizimi i kapitalizuar i prona, makineri dhe pajisje që i përket aktiveve në proces është 30,752,695 Lek në 2014 (2013: 19,805,042 Lek). Rakordimi i amortizimit të kapitalizuar dhe të njohur si shpenzim paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**
Amortizimi i kapitalizuar	30,752,695	19,805,042
Amortizimi i njohur si shpenzim	12,584,608	11,681,637
Totali	**43,337,303**	**31,486,679**

8. Aktive jomateriale

Aktivet jomateriale janë të përbëra si vijon:

	Programe kompjuterike	**Aktive të tjera jo-materiale**	**Totali**
Kosto			
Më 1 janar 2013	**25,088,199**	**7,438,305**	**32,526,504**
Shtesa	6,647,489	-	6,647,489
Pakësime	(8,421,314)	-	(8,421,314)
Më 31 dhjetor 2013	**23,314,374**	**7,438,305**	**30,752,679**
Shtesa	412,517	2,682,316	3,094,833
Më 31 dhjetor 2014	**23,726,891**	**10,120,621**	**33,847,512**
Zhvlerësim i akumuluar			
Më 1 janar 2012	**6,898,059**	**1,925,034**	**8,823,093**
Zhvlerësimi i vitit	3,969,974	1,115,746	5,085,720
Pakësime	(587,708)	-	(587,708)
Më 31 dhjetor 2013	**10,280,325**	**3,040,780**	**13,321,105**
Zhvlerësimi i vitit	3,284,295	1,194,360	4,478,655
Më 31 dhjetor 2014	**13,564,620**	**4,235,140**	**17,799,760**
Vlera kontabël (neto)			
Më 1 janar 2013	**18,190,140**	**5,513,271**	**23,703,411**
Më 31 dhjetor 2013	**13,034,049**	**4,397,525**	**17,431,574**
Më 31 dhjetor 2014	**10,162,271**	**5,885,481**	**16,047,752**

9. Parapagime

Parapagimet janë të përbëra si vijon:

Afatgjata	**Më 31 dhjetor 2014**	**Më 31 dhjetor 2013**
Parapagime për nënkontraktorët:		
Limak Insaat Sanayie ve Ticaret Anonim	511,266,705	363,328,802
Alstom Renovables Espana S.L	387,701,983	-
Comelex-Dege e Shoqerise se Huaj	267,879,430	-
Alstom Grid Enerji Endustrisi A.S	234,665,807	-
Të tjera	165,182,306	-
	1,566,696,231	**363,328,802**
Shpenzime të parapaguara	212,270,554	330,747,099
Totali	**1,778,966,785**	**694,075,901**
Afatshkurtra		
Parapagime për nënkontraktorët:		
Limak Insaat Sanayie ve Ticaret Anonim	732,537,050	40,246,225
Doko Sh.p.k	52,912,572	117,954,728
Trema Engieneering 2 Sh.p.k.	17,577,994	50,180,066
Të tjera	14,390,424	33,518,952
	817,418,040	**241,899,971**
Shpenzime të parapaguara	149,309,899	68,339,228
Aktive të parapaguara	20,858,463	20,858,463
Qira e parapaguar për garanci	7,472,657	7,472,657
Totali	**995,059,059**	**338,570,319**

Pjesa afatgjatë e parapagimeve për nënkontraktorët më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 përfaqëson shumën e parapaguar për punimet civile në hidrocentralin e Banjës. Pjesa afatgjatë e shpenzimeve të parapaguara më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 përfaqëson vlerën e parapaguar për "Sigal Uniqa Group Sh.a" për sigurimin e projektit.

Pjesa afatshkurtër e parapagimeve për nënkontraktorët më 31 dhjetor 2014 kryesisht paraqet shumën e parapaguar për "Sigal Uniqa Group Sh.a" në shumën e 118,477 mijë Lek (2013: 59,238 mijë Lek), shpenzime të parapaguara për antiviruse dhe garancinë e programeve kompjuterike në shumën prej 2,163 mijë Lek (2013: 4,098 mijë Lek), për qira zyre, magazine dhe apartamenti në Gramsh dhe Tiranë, në vlerën prej 340 mijë Lek (2013: 2,208 mijë Lek) dhe shpenzime të tjera të parapaguara për sigurimin e makinave dhe licenca të programeve kompjuterike.

Aktivet e parapaguara më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 përfaqësojnë shumën e parapaguar për përmirësime të punimeve për ndërtimin e rrugës Gramsh Kodovjat

10. Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2014	**Më 31 dhjetor 2013**
TVSH e zbritshme	85,702,511	83,443,225
TVSH për tu rimbursuar	226,818,974	491,864,936
Të tjera	152,440	-
Totali	**312,673,925**	**575,308,161**

10. Të tjera të arkëtueshme (vazhdim)

TVSH e blerjeve përfaqëson TVSH-në e zbritshme të deklaruar nga Shoqëria gjatë vitit financiar.

TVSH për t'u rimbursuar përfaqëson vlerën e TVSH-së së zbritshme për të cilën Shoqëria ka aplikuar për rimbursim. Kërkesa e parë për rimbursim është dorëzuar në 2011.

Në shkurt 2013, Shoqëria ka qënë subjekt i një kontrolli tatimor. Bazuar në raportin e kontrollit tatimor datë 9 prill 2013, Autoritetet Tatimore kanë vlerësuar detyrime shtesë për TVSH në shumën 16,510,387 Lek duke reduktuar përkatësisht balancën e TVSH-së për t'u rimbursuar të paraqitur në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2013.

Në maj 2013, Shoqëria ka aplikuar për rimbursimin e TVSH-së së zbritshme që rezulton deri më datë 31 dhjetor 2012 në shumën 143,686,908 Lek e cila është paraqitur nën zërin "TVSH për tu rimbursuar" më 31 dhjetor 2013.

Në prill 2014, Shoqëria aplikoi për rimbursimin e TVSH-së së zbritshme që rezulton deri më 31 dhjetor 2013 prej 83,449,273, e cila paraqitet nën zërin TVSH për t'u rimbursuar më 31 dhjetor 2014.

Në tetor 2013, Shoqëria ka qenë subjekt I një kontrolli tatimor I cili vazhdoi deri në Qershor 2014. Bazuar në raportin e kontrollit tatimor datë 27 qershor 2014, Autoritetet Tatimore vlerësuan detyrime shtesë për TVSH-në në shumën prej 90,321 Lek lidhur me TVSH-në për t'u rimbursuar për vitin 2012 dhe 220,894 Lek për vitin 2013. Këto shuma janë rregulluar përkatësisht dhe shuma e TVSH-së për t'u rimbursuar (reduktuar me 311,215) është reflektuar në këto pasqyra financiare.

Gjatë 2014 autoritetet tatimore kanë rimbursuar Shoqërinë me shumën prej 348,178,026 Lek (2013: 0 Lek)

11. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Mjete monetare në arkë		
Arka (në Lek)	316,522	107,900
Arka (në EUR)	218,645	113,855
	535,167	**221,755**
Mjete monetare në bankë		
Llogari rrjedhëse (në Lek)	14,369,763	6,394,463
Llogari rrjedhëse (në EUR)	3,563,244,829	2,361,657,349
Llogari "Escrow" në Lek	6,976,045	6,820,093
Depozita me afat me maturim deri në 3 muaj	50,000,000	-
	3,634,590,637	**2,374,871,905**
Totali	**3,635,125,804**	**2,375,093,660**

Llogaria "Escrow" është hapur me qëllimin për të transferuar pagesat në favor të pronarëve të shpronësuar sipas Akt-Marrëveshjes nr. 819/2 prot., datë 27.02.2012 ndërmjet METE (aktualisht MEI) and Devoll Hydropower Sh.A. Kjo marrëveshje bazohet në Vendimin nr.656, datë 26.09.2012, pika 7, të Këshillit të Ministrave, i cili kërkon që pronarët të cilëve u referohet vendimi, të kompensohen për shpronësimin e pronave të tyre nga METE (aktualisht MEI) në bashkëpunim me Devoll Hydropower Sh.A.

Depozita me afat më 31 dhjetor 2014 përfaqëson depozita njëditore ("overnight") me interes të barabartë me 1%.

12. Kapitali aksionar

Numri dhe vlera nominale e aksioneve të regjistruara më 31 dhjetor 2014

Më 31 dhjetor 2014 kapitali aksionar i regjistruar i Shoqërisë është 22,319,000,000 Lek (2013: 11,100,000,000 Lek) i ndarë në 22,319 aksione të zakonshme me vlerë nominale secila prej 1,000,000 Lek (2013: 11,100 aksione të zakonshme me vlerë nominale secila prej 1,000,000 Lek).

Aksionarët

Tabela e mëposhtme tregon aksionarët e Shoqërisë, mbajtës të aksioneve më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 së bashku me numrin dhe përqindjen e aksioneve totale të emetuara.

	Më 31 dhjetor 2014		Më 31 dhjetor 2013	
	Numri i aksioneve	% e kapitalit aksionar të emetuar	Numri i aksioneve	% e kapitalit aksionar të emetuar
Statkraft Markets B.V	22,319	100%	11,100	100%
Totali	**22,319**	**100%**	**11,100**	**100%**

Më 31 dhjetor 2014 kapitali aksionar i Shoqërisë që është regjistruar në QKR ka vlerën 22,319,000,000 Lek dhe është paguar tërësisht.

13. Primi i kapitalit aksionar

Më 31 dhjetor 2014 primi i kapitalit të Shoqërisë është 7,090,000 Lek (2013: 6,190,000 Lek). Gjatë vitit 2013 Shoqëria ka rishikuar numrin dhe vlerën nominale të aksioneve për të eliminuar diferencat në kurset e këmbimit që rezultojnë nga konvertimi në Lek i vlerës së aksioneve të viteve të mëparshme të emetuara në monedhë të huaj. Ndryshimi në vlerën nominale dhe numrin e aksioneve është regjistruar në QKR përkatësisht më 5 mars 2013 dhe 18 shtator 2013

Rritja në primin e kapitalit gjatë 2014 lidhet me kontributet e aksionareve i regjistruar në QKR më 8 korrik 2014.

14. Shpenzime të përllogaritura

Shpenzimet e përllogaritura përbëhen nga shërbimet e kryera nga palët e tjera si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Ndaj palëve të lidhura		
Statkraft AS	158,550,978	57,986,923
	158,550,978	**57,986,923**
Ndaj palëve të tjera		
Limak Insaat Sanayie ve Ticaret Anonim	533,019,395	303,396,163
Alstom Group – Elmech Works	414,455,922	-
Alstom Group - Hydro Works	166,901,443	-
AF Consultant Switzerland Ltd	160,768,566	-
Trema Engieneering 2 Sh.p.k.	70,070,000	
Sweco Norge AS	59,279,220	
Mott MacDonald	42,334,360	1,915,132
Doko Sh.p.k	28,460,476	70,805,565
Të tjera	26,828,654	1,104,777
Alstom Renovables Espania	-	128,909,756
Euroteorema Peqin Sh.p.k.	-	60,352,504
AON	-	20,329,000
Coyne et Bellier	-	7,660,808
	1,502,118,036	**594,473,705**
Totali	**1,660,669,014**	**652,460,628**

15. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen si vijon:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Llogari të pagueshme ndaj palëve të tjera:		
Euroteorema Peqin Sh.p.k.	229,523,439	-
Doko Sh.p.k	139,076,274	122,413,080
Trema Engieneering 2 Sh.p.k.	82,855,182	50,012,405
Limak Insaat Sanayie ve Ticaret Anonim	73,732,152	-
Mott Macdonald Limited	51,311,733	-
Enbi Power Sh.p.k	50,005,565	
Dega ne Shqiperi e Sëeco Norge AS	42,053,598	
Ndalesa ndaj nënkontraktorëve	240,092,568	17,325,532
Të tjera	45,251,476	29,199,825
	953,901,987	**218,950,842**
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	37,258,544	22,865,723
		-
Totali	**991,160,531**	**241,816,565**

16. Të tjera të pagueshme

Detyrime të tjera përbëhen si vijon:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Detyrime ndaj punonjësve	3,638,424	10,983,815
Tatimi mbi të ardhurat personale	7,720,158	2,970,068
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	2,839,828	1,191,922
Detyrime të tjera	570,404	590,000
Totali	**14,768,814**	**15,735,805**

17. Shërbime

Balanca e llogarisë përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Shërbimet nga pjesëtarët e grupit	70,554,564	35,518,746
Konsulencë e jashtme	51,910,811	40,915,478
Qira	33,486,512	27,709,359
Udhëtime dhe akomodime	25,270,072	10,857,287
Telefon, internet, shërbime postare	3,576,286	2,969,148
Të tjera	3,039,008	1,889,525
Të tjera shërbime konsulence	2,323,915	19,465,071
Sigurime	1,110,856	850,054
Totali	**191,272,024**	**140,174,668**

17. Shërbime (vazhdim)

Pjesa më e madhe e shërbimeve të kryera nga pjesëtarët e grupit më 31 dhjetor 2014 përbëhet nga shërbimet e kryera nga Statkraft AS sipas Marrëveshjes për Shërbime (SLA) dhe Marrëveshjes së Transferimit të Punonjësve me vlerë 51,180 mijë Lek (2013: 21,706 mijë Lek) së bashku me shërbime të kryera nga Statkraft Energy AS sipas Marrëveshjes për Shërbime (SLA) dhe Marrëveshjes së Transferimit të Punonjësve në vlerën 16,716 mijë Lek (2013: 10,293 mijë Lek).

18. Kosto personeli

Kostot e personelit përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Paga	223,164,448	102,059,002
Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	16,217,559	7,181,763
Të tjera	6,911,791	4,719,364
Kosto personeli të kapitalizuara	(174,190,543)	(80,661,385)
Totali	**72,103,255**	**33,298,744**

19. Shpenzime të tjera

Shuma përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Shpenzime për mbështetjen e komunitetit	20,987,002	-
Shpenzime zyre	9,577,742	7,241,554
Shpenzime reklame	6,483,985	7,017,191
Gjoba dhe kamatëvonesa	4,970,431	16,513,273
Shpenzime përfaqësimi	4,185,111	2,929,317
Të tjera shpenzime	4,125,676	6,955,385
Shpenzime sponsorizimi	2,606,456	6,004,372
Mirëmbajtje pajisjesh	2,217,885	2,485,088
Komisione bankare	1,774,321	1,346,697
Karburant dhe mirëmbajtje makine	39,750	74,112
Humbje nga nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve	-	8,653,736
Totali	**56,968,359**	**59,220,725**

Shpenzimet për mbështetjen e komunitetit përfaqësojnë kosto të ndryshme të përballuara nga Shoqëria në mbështetje të grupeve te interesit që preken nga projekti i hidrocentraleve.

20. (Humbja)/Fitimi nga kurset e këmbimit, neto

Shuma përbëhet nga sa vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Fitimet nga diferencat në kurset e këmbimit	86,840,063	46,217,660
Humbjet nga diferencat në kurset e këmbimit	(113,949,038)	(43,352,808)
(Humbja)/Fitimi nga kurset e këmbimit, neto	**(27,108,975)**	**2,864,852**

21. Të ardhura financiare, neto

E ardhura financiare përbëhet nga sa vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Të ardhura nga interesat	18,425,758	7,537,981
Shpenzime për interesa	(19,006)	(203)
Të ardhura financiare, neto	**18,406,752**	**7,537,778**

22. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin për periudhën

Shoqëria nuk ka kryer ndonjë parapagim për tatimin mbi fitimin gjatë vitit 2014 (2013: Zero). Përgjithësisht, tatimi mbi fitimin i parapaguar, nëse ka, mund të kompensohet nga shpenzimi për tatimin mbi fitimin, nëse ka, pas kontrolleve të ardhshme të autoriteteve tatimore.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Humbja për vitin	**(341,630,469)**	**(233,973,144)**
Shpenzime të pazbritshme	76,987,677	60,690,677
Humbja tatimore për vitin	**(264,642,792)**	**(173,282,467)**
Tatimi mbi fitimin @ 15% (2013 @10%)	-	-
Humbja tatimore e mbartur	**(264,642,792)**	**(173,282,467)**

Më poshtë është paraqitur një rakordim i normës efektive të tatimit:

	2014	Norma efektive	2013	Norma efektive
Humbja për vitin	**(341,630,469)**		**(233,973,144)**	
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën tatimore të Shoqërisë	(51,244,570)	(15%)	(23,397,314)	(10%)
Tatimi mbi fitimin për shpenzimet e pazbritshme	11,548,151	3.38%	6,069,068	2.59%
Tatimi mbi fitimin për humbjet e vitit aktual për të cilat nuk është njohur tatim i shtyrë aktiv	39,696,419	11.62%	17,328,246	7.41%
Totali i shpenzimit të tatimit mbi fitimin	-	-	-	-

22. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi i shtyrë

Më 31 dhjetor 2014 nuk është njohur tatim i shtyrë aktiv për sa i përket zërave të mëposhtëm:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Humbjet tatimore nga 2012	-	-
Humbjet tatimore nga 2013	-	-
Humbjet tatimore nga 2014	264,642,792	-
	264,642,792	-

Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vjet. Humbjet nga 2012 dhe 2013 nuk janë mbartur sepse bazuar në Ligjin Nr. 8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar Neni 27, Paragrafi 2, humbjet tatimore nuk mund të mbarten për shkak të ndryshimit të strukturës së pronësisë me më shumë se 50% (referoju shënimit 1).

Diferencat e zbritshme të përkohshme nuk skadojnë sipas legjislacionit tatimor aktual. Nuk është njohur tatim i shtyrë aktiv më 31 dhjetor 2014 në lidhje me këto zëra pasi nuk ka siguri se fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i mjaftueshëm për të kompensuar humbjet tatimore të mbartura.

23. Palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqërinë mëmë dhe drejtuesit kryesor. Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura paraqitet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Shpenzime te përllogaritura		
Statkraft AS	158,550,978	57,986,923
	158,550,978	**57,986,923**

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Detyrime ndaj palëve të lidhura		
Statkraft AS	20,232,704	20,782,931
Stakraft Enerji A.S.	15,197,145	-
Statkraft Energi AS	1,828,695	2,082,792
Totali	**37,258,544**	**22,865,723**

23. Palët e lidhura (vazhdim)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
Transaksione me palë të lidhura		
Kapitalizuar si aktive në proçes	*437,572,818*	*141,767,169*
Statkraft AS	406,844,212	119,947,088
Stakraft Enerji A.S.	17,698,086	-
Statkraft Energi AS	12,613,988	47,429
Statkraft Markets GmbH	416,532	279,677
Statkraft Development AS	-	20,838,430
Kompensimi i drejtuesve kryesorë	-	654,545
Shpenzime në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	*114,295,331*	*42,373,553*
Statkraft AS	51,180,144	21,705,751
Statkraft Energi AS	16,715,639	10,293,471
Stakraft Enerji A.S.	2,658,780	
Statkraft Development AS	-	3,519,524
Kompensimi i drejtuesve kryesorë	43,740,768	6,854,807

Siç përshkruhet në Shënimin 1 nga 28 marsi 2013 ortaku i vetëm i Shoqërisë është Statkraft Markets B.V dhe kompania mëmë dhe filialet e saj janë e vetmja palë e lidhur.

24. Instrumente financiarë

(a) Rreziku i kreditimit

Shuma e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kreditimit. Maksimumi i ekspozimit financiar ndaj rrezikut të kreditimit në datën e raportimit ishte:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	3,635,125,804	2,375,093,660
	3,635,125,804	**2,375,093,660**

(b) Humbja nga zhvlerësimi

Shoqëria nuk ka llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013. Për rrjedhojë nuk ekzistojnë tregues të zhvlerësimit për klasat e tjera të aktiveve financiare në atë datë. Duke pasur parasysh se Shoqëria aplikon ligjet dhe rregulloret në fuqi ne besojmë se nuk ka shenja të zhvlerësimit të TVSH-së së arkëtueshme.

24. Instrumente financiarë (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të detyrimeve financiare deri më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

31 dhjetor 2014	Vlera kontabël (neto)	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet
Detyrime ndaj palëve të lidhura	195,809,522	195,809,522	-	-	-
Detyrime ndaj palëve të tjera	2,456,020,023	2,215,927,455	240,092,568	-	-
Detyrime të tjera	14,768,814	14,768,814	-	-	-
Totali	**2,666,598,359**	**2,426,505,791**	**240,092,568**	-	-

31 dhjetor 2013	Vlera kontabël (neto)	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet
Detyrime ndaj palëve të lidhura	80,852,646	80,852,646	-	-	-
Detyrime ndaj palëve të tjera	813,424,547	787,629,950	25,794,597	-	-
Detyrime të tjera	15,735,805	15,735,805	-	-	-
Totali	**910,012,998**	**884,218,401**	**25,794,597**	-	-

Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të aktiveve financiare deri më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

31 dhjetor 2014	Vlera kontabël (neto)	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet
Të tjera të arkëtueshme	312,673,925	226,971,414	-	85,702,511	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3,635,125,804	3,635,125,804	-	-	-
Totali	**3,947,799,729**	**3,862,097,218**	-	**85,702,511**	-

31 dhjetor 2013	Vlera kontabël (neto)	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet
Të tjera të arkëtueshme	575,308,161	489,864,936	-	83,443,225	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	2,375,093,660	2,375,093,660	-	-	-
Totali	**2,950,401,821**	**2,864,958,596**	-	83,443,225	-

24. Instrumente financiarë (vazhdim)

(d) Rreziku ndaj kursit të këmbimit

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 ishte si vijon:

31 dhjetor 2014	Vlera kontabël (neto)	Euro (konvertuar në Lek)	Të tjera (konvertuar në Lek)	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	3,635,125,804	3,613,463,473	-	21,662,331
Të arkëtueshme të tjera	312,673,925	-	-	312,673,925
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(195,809,522)	(195,809,522)	-	-
Detyrime ndaj palëve të tjera	(2,456,020,023)	(2,443,416,861)	(3,323,238)	(9,279,924)
Detyrime të tjera	(14,768,814)	-	-	(14,768,814)
Ekspozimi Neto	**1,281,201,370**	**974,237,090**	**(3,323,238)**	**310,287,518**

31 dhjetor 2013	Vlera kontabël (neto)	Euro (konvertuar në Lek)	Të tjera (konvertuar në Lek)	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	2,375,093,660	2,361,771,203	-	13,322,457
Të arkëtueshme të tjera	575,308,161	-	-	575,308,161
Detyrime ndaj palëve të lidhura	(80,852,646)	(80,852,646)	-	-
Detyrime ndaj palëve të tjera	(813,424,547)	(803,692,244)	-	(9,732,303)
Detyrime të tjera	(15,735,805)	-	-	(15,735,805)
Ekspozimi Neto	**2,040,388,823**	**1,477,226,313**	**-**	**563,162,510**

Gjatë vitit janë përdorur kurset e mëposhtme të këmbimit:

	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2014	**2013**	**2014**	**2013**
Lek/EUR	140.03	140.2	140.14	139.04

Analiza e ndjeshmërisë ndaj kurseve të këmbimit

Analiza e mëposhtme e ndjeshmërisë është përcaktuar bazuar në ekspozimin e monedhës së huaj në datën e raportimit dhe në ndryshimet e llogaritura në fillim të vitit financiar të mbajtura konstante gjatë gjithë periudhës raportuese. Më poshtë jepet një përcaktim i efektit të ndryshimeve të kurseve të këmbimit në fitimin neto, duke i konsideruar të gjithë variablat e tjerë të mbajtur konstant:

	2014	**2013**
EUR zhvlerësohet me 10%	(97,423,709)	(147,722,631)
EUR vlerësohet me 10%	97,423,709	147,722,631

24. Instrumente financiarë (vazhdim)

(e) Rreziku i normës së interesit

Natyra

Në datën e raportimit, natyra e normave të interesit të instrumenteve që sjellin interes financiar për Shoqërinë ishte si vijon:

	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013
Instrumente me normë fikse		
Aktivet financiare	50,000,000	-

Aktivet financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014 përfaqësohen nga depozita njëditore ("overnight") me interes të barabartë me 1%.

Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse

Shoqëria nuk llogarit për asnjë prej aktiveve dhe detyrimeve financiare me normë fikse me vlerën e drejtë, diferenca të cilat kalojnë nëpërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve dhe Shoqëria nuk përdor derivativë (swap për norma interesi), si instrumente mbrojtës, sipas një modeli kontabël mbrojtjeje me vlerën e drejtë. Prandaj një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojë në fitimin ose humbjen e Shoqërisë.

25. Angazhime dhe detyrime të ardhshme

Angazhime për qiranë operative

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte lidhur njëzetë e katër (2013: njëzetë) kontrata qiraje të zakonshme në lidhje me qiranë e zyrave në Tiranë dhe Gramsh dhe magazinave në Gramsh, hapësira parkimi dhe apartamente. Pagesat e ardhshme minimale të qirasë në bazë të kontratave janë si vijon:

	2014	2013
Brenda një viti	37,634,765	50,127,483
Pas më shumë se një por më pak se pesë vjetësh	8,302,608	12,685,170
	45,937,373	**62,812,653**

Shpenzimet e qirasë bazuar në marrëveshjen e qirasë për zyrën në Tiranë dhe apartamentet në Gramsh për vitet që mbarojnë më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, ishin përkatësisht 33,437,779 Lek dhe 27,709,359 Lek dhe janë përfshirë në pasqyrën shoqëruese të të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Shpenzimet e qirasë bazuar në marrëveshjen e qirasë në Gramsh për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 ishin 18,195,524 Lek (2013: 7,761,476 Lek) dhe janë përfshirë në pasqyrën shoqëruese të pozicionit financiar.

Garancia e Kontratës

Duke iu referuar pikës 7.3.14 të Marrëveshjes Koncesionare "Garancia e Kontratës", koncesionari i ka paraqitur Autoritetit Kontraktues "METE" (aktualisht MEI) një Garanci Kontratë, e cila është thelbësisht në përputhje me formatin e paraqitur në Shtojcën D të Marrëveshjes së Koncesionit.

Garancia e Kontratës me vlerë fillestare 50 milion Euro i është dhënë Autoritetit Kontraktues në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Koncesionit dhe në çdo ripërtëritje të mëpasshme Garancia e Kontratës do të jetë e vlefshme për një minimum prej një viti siç përshkruhet në pikën 7.3.14 (b) të Marrëveshjes së Koncesionit.

Autoriteti Kontraktues ka rënë dakord se shuma fillestare e Garancisë së Kontratës do të zvogëlohet si më poshtë vijon:

a) 12.5 milion Euro pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Banjës)

b) 18.75 milion Euro pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Lozhan-Grabovës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Lozhan-Grabovës)

25. Angazhime dhe detyrime të ardhshme (vazhdim)

Garancia e Kontratës (vazhdim)

c) 18.75 milion Euro tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Skënderbegas-Cekinit (nga ku zbriten shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Skënderbegas-Cekinit)

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë Garancinë e Kontratës për çdo dëm të likuidimit sipas pikës 7.3.11 (a) të Marrëveshjes së Koncesionit, nëse koncesionari dështon të paguajë shuma të tilla brenda afateve të specifikuara në seksionin 7.2.5 të Marrëveshjes së Koncesionit.

Angazhimet për kapitalin sipas Marrëveshjes Koncesionare

Bazuar në Marrëveshjen Koncesionare të nënshkruar midis koncesionarit dhe METE (aktualisht MEI), koncesionari është përgjegjës për planifikimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll.

Angazhimet për kapitalin që rrjedhin nga shpronësimet e pasurive te paluajtshme

Bazuar në vendimin nr. 656 të Këshillit të Ministrave datë 26.09.2012, u mor vendimi për shpronësimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme që u prekën nga ndërtimi i projektit hidroenergjitik mbi lumin Devoll. Pronat që janë subjekt i shpronësimit do të kalojnë në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes (METE - aktualisht MEI) e cila më pas do t'i transferojë Shoqërisë të drejtën e përdorimit të pronave.

Vlera totale e pronave që janë subjekt i shpronësimit në vlerën 278,146,847 Lek dhe shpenzimet procedurale në vlerën 12,360,000 Lek do të mbulohen nga Shoqëria. Angazhimet në vlerën prej 156,322,090 Lek janë detyrime për t'u shlyer në të ardhmen.

Bazuar në vendimin Nr. 661 të Këshillit të Ministrave, datë 07.08.2013, u vendos për shpronësimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme që u prekën nga ndërtimi i Linjave të Transmetimit prej 110 kV dhe 220 Kv për lidhjen e kaskadës së lumit Devoll me rrjetin e sistemit të transmetimit shqiptar. Pronat që janë subjekt i shpronësimit do të kalojnë në favor të OST.

Vlera totale e pronave që janë subjekt i shpronësimit në vlerën 2,153,924 Lek dhe shpenzimet procedurale në vlerën 446,960 Lek do të mbulohen nga Shoqëria

Bazuar në vendimin nr. 674 të Këshillit të Ministrave, datë 15.10.2014, u vendos për shpronësimin e pronarëve të prekur nga rikonstruksioni i rrugës publike në vendndodhjen 2 dhe 3 përgjatë kaskadës së Devollit të nevojshme për ndërtimin e impiantit të Moglicës. Pronat subjekt i shpronësimit do të transferohen në pronësi të Autoritetit Shqiptar të Rrugëve.

Vlera totale e pronave që janë subjekt i shpronësimit në vlerën 2,726,182 Lek dhe shpenzimet procedurale do të mbulohen nga Shoqëria.

Detyrime të kushtëzuara dhe procedura ligjore që rrjedhin nga kontrolli tatimor

Shoqëria ka qenë subjekt i një ri-kontrolli tatimor për TVSH gjatë vitit 2012 dhe i një kontrolli për TVSH gjatë vitit 2013. Bazuar ne raportin e kontrollit tatimor datë 22 dhjetor 2011 dhe raportit të ri kontrollit tatimor datë 8 gusht 2012 autoritetet tatimore vlerësuan penalitete për TVSH-në në vlerën 91,116,619 Lek. Shoqëria nuk ka llogaritur ndonjë provigjion në pasqyra financiare për penalitetet për shkak se Drejtimi e ka dërguar çështjen në gjykatë dhe beson në një rezultat të suksesshëm.

Për më tepër, bazuar në raportin e kontrollit tatimor datë 9 prill 2013 dhe raportit te apelimit tatimor date 9 gusht 2013, autoritetet tatimore kanë vlerësuar penalitete për TVSH-në ne vlerën 16,243,181 Lek. Shoqëria nuk ka njohur ndonjë provigjion në këto pasqyra financiare sepse Drejtimi e ka dërguar çështjen në gjykatë dhe beson në një rezultat të suksesshëm.

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë procedure tjetër ligjore, ankimimi ose çështje gjyqësore gjatë rrjedhës normale të biznesit.

26. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Më 12 shkurt 2015 Parlamenti Shqiptar aprovoi Ligjin Nr. 7/2015 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083, datë 23.2.2009". Nëpërmjet këtij Ligji u aprovua Shtojca 3 e Marrëveshjes së Konçesionit, sipas se ciles, Konçesionari duhet të marrë përsipër përgjegjësinë për zëvendësimin e punimeve në infrastrukturë përfshirë financimin, dizenjimin, planifikimin, tenderimin, ndërtimin dhe dorëzimin e infrastrukturës zëvendësuese të lidhur me projektin e Hidrocentraleve mbi lumen Devoll, me kusht që Autoriteti Kontraktues te rimbursoje të gjitha kostot infrastrukturore. Sipas Shtojces 3, DHP duhet të nisë ndërtimin e impiantit Kokel, nëse konçesionari, sipas gjykimit të tij, zgjedh ta ndërtojë atë. Ky Ligj hyri ne fuqi me 24 Mars 2015.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit për të cilat nevojiten rregullime apo shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.